



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 1550 prot.

Tiranë, më 04.06.2024

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 3138/1, DATË 11.12.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, “PËR ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR TË ANKESAVE TË BASHKUARA TË PARAQITURA NGA SHTETASJA ZNJ. KLODJANA ÇELA”

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e bashkuara të paraqitura nga znj. Klodjana Çela me nr. 3345 prot., datë 28.07.2021, nr. 3345/2 prot., datë 02.08.2021, në të cilat ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistrates A.C.(Z). me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në kohën e kryerjes së shkëljes së pretenduar dhe me vendimin nr. 3138/1 prot., datë 11.12.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara të paraqitura nga shtetasja znj. Klodjana Çela”, bazuar në nenin 121, pika 2, shkronja “a” e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Tiranë, sipas adresës së lënë nga ankuesi; Fushë-Mëzes; Njësia Administrative Kashar; Pallati “Elvis”, Tiranë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al.

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

